

1 E enjte, 19 dhjetor 2024
2 [Seancë e hapur]
3 [Seancë mbi Marrëveshjen për Pranimin e
4 Fajësisë]
5 [I akuzuari Shala nuk është paraqitur]
6 [I akuzuari Bahtijari hyn në sallën e gjyqit]
7 [I akuzuari Januzi paraqitet përmes
8 videolidhjes]
9 --- Seanca fillon në orën 13.00

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
11 çaktivizuar].

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
13 lënda KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar kundër Sabit
14 Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
16 çaktivizuar].

17 [Përkthim] Ju lutem palëve të prezantohen, do të fillojmë
18 me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

19 Fjala është për ju.

20 Z. DEVANEY: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës.
21 Mirëdita në fakt të gjithëve në sallën e gjyqit. Këtu është
22 Zëvendësprokurori i Përgjithshëm Ward Ferdinandusse, që është
23 pas meje në të djathtën time, në të majtën time është
24 administratorja e lëndës, Line Pedersen dhe në të djathtën
25 time Prokurorja, Tazneen Shahabuddin dhe unë jam

1 Ndhmësprokuror, John Devaney.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Po i drejtohem Mbrojtjes tani. Ju lutem na thoni cilët
5 janë të pranishëm në sallën e gjyqit, cilët po na ndjekin
6 përmes videolidhjes. Fillojmë me Mbrojtjen e z. Bahtijari.

7 Fjala është për ju.

8 ZNJ. GERRY [Përkthim] Unë jam avokatja, Felicity Gerry,
9 kam bashkëmbrojtësen Marion Carrin, juristen këtu Yuqing Liu,
10 që është po ashtu e pranishme në sallën e gjyqit. Gjithashtu,
11 ne kemi përmes videolidhjes Phillipa Stafford, administratoren
12 tonë, Cassandra Le Good dhe Ismar Ridzalovic, që janë
13 stazhiere. Gjithashtu kemi dhe një administratore tjetër që
14 quhet Caitlin Delaney.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
16 z. Bahtijari është vetë në sallën e gjyqit.

17 Mbrojtja e z. Shala.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Toby Cadman. Mirëdita. Unë jam Toby
19 Cadman, Mbrojtësi i Specializuar dhe bashkë me mua këtu
20 Isabella Kirwan, juriste. Z. Shala nuk është i pranishëm dhe
21 nuk po na ndjek as përmes videolidhjes dhe për këtë ka kërkuar
22 leje ditën e djeshme.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Tani Mbrojtja e z. Januzi. Fjala është për ju.

1 Z. REES: [Përkthim] Unë jam Jonathan Elystan Rees. Jam
2 avokati i z. Januzi. Kam z. Huw Bowden këtu që është
3 bashkëmbrojtës dhe, po ashtu, kemi dhe ndihmës në sallën e
4 gjyqit z. Muharrem edhe znj. Elin Morgan.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull atëherë. Z. Januzi po na ndjek përmes videolidhjes.

7 Sa i takon transparencës së seancave publike, unë e
8 thashë edhe dje, por do ta përsërisë dhe sot, që ne duam që
9 seancat t'i kemi publike. Dhe ju kujtoj palëve se nëse është e
10 nevojshme të kalojmë në seancë private për arsye fshehtësie
11 apo për të mos nxjerrë asnjë informacion konfidencial, ju
12 lutem më njoftoni menjëherë dhe do të vendosim ne.

13 Seanca e sotme është për të diskutuar dhe për të dëgjuar
14 parashtrimet e Mbrojtjes së z. Ismet Bahtijari lidhur me
15 aspekte të ndryshme që lidhen me marrëveshjen për pranimin e
16 fajësisë që ka numrin F0628, Shtojca 1.

17 Trupi Gjygues rikujton se nuk do të dalë sot me vendim
18 nëse do të miratojë marrëveshjen, përfshirë këtu për dënimin.
19 Trupi Gjygues këtë vendim do ta nxjerrë në momentin e duhur.

20 Sot plani është si në vijim. Fillimisht do t'i kërkojmë
21 z. Bahtijari të konfirmojë në bazë të rregullave 94(5)(a) deri
22 në (d) të Rregullores nëse avokatja i ka diskutuar me të
23 kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Po do ta
24 pyesim po ashtu a i kupton z. Bahtijari kushtet e kësaj
25 marrëveshjeje, nëse z. Bahtijari i konfirmon pranimin e

1 fakteve lidhur me akuzat që gjenden në marrëveshjen për
2 pranimin e fajësisë, dhe nëse z. Bahtijari është pajtuar për
3 këtë marrëveshje vullnetarisht, pa e kërcënuar askush dhe pa e
4 detyruar ndokush dhe, nëse i kupton z. Bahtijari pasojat e
5 kësaj marrëveshjeje dhe heq do të nga e drejta për t'u gjykuar
6 sipas procesit të rregullt gjyqësor.

7 Më pas do të shohim nëse kemi nevojë për një seancë
8 tjetër që mund ta bëjmë nga ora 3.30 ose menjëherë pasi të
9 përfundojmë seancën. Do shohim si do të jenë zhvillimet nëse
10 ka nevojë për pushim apo jo dhe sigurisht sesa aspekte ka ende
11 për t'u diskutuar. Sidoqoftë kjo është për të tri palët në
12 këtë rast.

13 Në rregull. Vazhdojmë tani me seancën për pranimin e
14 fajësisë për z. Bahtijari. Shoh që është çuar në këmbë
15 avokatja e z. Bahtijari.

16 ZNJ. GERRY [Përkthim] Shkurtimisht. Siç e dini, unë kisha
17 kërkuar që znj. Liu të ulej me z. Bahtijari. Dhe më thatë për
18 arsye sigurie nuk do të lejohej, por do të donim që ta
19 ndihmonte dikush t'ia tregonte në ekran se ku duhet të lexojë.
20 Se mbase mund të hutohet në ndonjë moment nga pyetjet tuaja
21 dhe ku është nevoja të lexojë, që ta kuptojë se çfarë duhet të
22 lexojë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Avokate, ju ishit dje e pranishme edhe dje u bë, ju e pohuat
25 dhe ju e patë që ne i ndihmuam të dy të akuzuarit dje. Sot ne

1 do të kemi një nga Sekretaret e Gjykatës që do ta ndihmojë
2 klientin tuaj, do të qëndrojë Sekretarja e seancës pranë z.
3 Bahtijari. Dhe do të jap unë udhëzimet e nevojshme se çfarë
4 duhet t'i tregoj në ekran, që të sigurohemi që klienti vërtet
5 po i kupton ato që ne i lexojmë, sigurisht që ky është synimi
6 kryesor.

7 ZNJ. GERRY [Përkthim] Faleminderit. Dhe faleminderit
8 gjithë personelit tuaj që na ka ndihmuar kaq shumë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Për procesverbal, vërej se marrëveshja është nënshkruar
12 mes z. Bahtijari dhe Prokurorit të Specializuar më 16 dhjetor
13 2024 dhe se avokatja e të akuzuarit është Felicity Gerry.

14 Avokate, mund ta konfirmoni?

15 ZNJ. GERRY [Përkthim] E kam Gerry s'e kam Xherry, po për
16 mua bëhet fjalë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Gerry
18 atëherë. Gerry. Më falni, Gerry. Mirë.

19 Përpara se të fillojmë, i lutem Sekretares së seancës të
20 vendosë në ekran marrëveshjen për pranimin e fajësisë që mban
21 numrin 628, Shtojca 1.

22 Z. Bahtijari, ky është dokumenti që e ka titullin
23 "Marrëveshja për pranimin e fajësisë", që është dorëzuar
24 Trupit Gjykes si Shtojca 1 e dokumentit me numër 628, është
25 pikërisht dokumenti që është aktualisht në ekran.

1 I lutem Sekretares së seancës të shkojë në faqen 10. Po.

2 Ju lutem dhe në shqip në të njëjtën faqe.

3 Kam një pyetje për ju, z. Bahtijari. Në të majtë, në të
4 majtë të ekranit, në të majtë është një nënshkrim. Nënshkrimi
5 që po shohim ne, nënshkrimi e shikoni që po ua tregon
6 Sekretarja e seancës. Nënshkrimi i juaj është?

7 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Z. Bahtijari, do t'ju jap disa udhëzime për mikrofonin.
11 Sa herë që doni të flisni me Trupin Gjykses duhet të ndizni --
12 sa herë që doni të merrni fjalën duhet të shtypni mikrofonin.
13 Po jua tregon oficeri i sigurisë. Se në qoftë se nuk e shtypni
14 ju atë butonin, ne nuk e dëgjojmë dhe as përkthyesit nuk e
15 dëgjojnë dhe s'e kuptojmë çfarë thoni.

16 Kujdes, ju lutem. E kuptojmë që nuk është e lehtë, vetëm
17 kijeni parasysh, sa herë që do flisni shtypni butonin. Dhe kur
18 të keni mbaruar fjalën, shtype prapë butonin dhe fiket ajo
19 drita e kuqe aty.

20 I AKUZUARI BAHTIJARI: Mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Arsyja është se duhet ta fikni ju se përndryshe nuk e dëgjon
23 atë që thuhet. Pra, është e rëndësishme që të jetë i fikur
24 mikrofonin, kur s'jeni duke folur. Po do ju ndihmojmë dhe ne
25 kur e shikojmë që keni ndonjë vështirësi.

1 Znj. Prokurore, jeni çuar në këmbë.

2 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Vërej për procesverbal që
3 transkripti nuk ka nxjerrë përgjigjen e z. Bahtijari për
4 paragrafin 24. Nuk ka dalë në transkript.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
6 Do ta bëjmë dhe një herë pyetjen. Dhe një herë pyetjen.

7 Z. Bahtijari, nënshkrimi në të majtë të ekranit në cep,
8 në qoshe të tekstit, a është nënshkrimi juaj? Shtyp
9 mikrofonin.

10 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
12 Shumë mirë. Faleminderit.

13 Shkojmë në të djathtë, shkojmë tek faqja në të djathtë
14 desha të thoja. Nënshkrimi në mes të faqes a është nënshkrimi
15 juaj, z. Bahtijari?

16 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Aty
18 ku shikojmë atë shigjetën?

19 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
21 Shumë faleminderit.

22 Shkojmë në faqen 22 tek shqipja. Faleminderit. Dhe në
23 faqen 11 të anglishtes. Faleminderit.

24 Tek paragrafi 26, z. Bahtijari, nënshkrimi i parë që
25 shohin ne poshtë paragrafit 26, a është nënshkrimi yt?

1 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Shkojmë në të djathtë të ekranit, nënshkrimi i parë, në
5 fillim të faqes poshtë numrit 26, a është nënshkrimi juaj, z.
6 Bahtijari?

7 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit që e konfirmuat.

10 Tani do flas me avokaten tuaj, po qëndrojmë në të njëjtat
11 faqe.

12 Avokate, a e konfirmoni që në të dyja faqet është
13 nënshkrimi juaj?

14 ZNJ. GERRY [Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Kthehemi tek faqet që më pamë më përpara 10 edhe 21. A
18 janë këto nënshkrimet tuaja?

19 ZNJ. GERRY [Përkthim] Po, janë nënshkrimet e mia.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit. Mirë atëherë.

22 Znj. Avokate, mund të qëndroni ulur po thjesht desha t'ju
23 pyes. Ju e ndihmuat z. Bahtijari që ta lexonte marrëveshjen
24 për pranimin e fajësisë dhe prandaj janë nënshkrimet tuaja?

25 ZNJ. GERRY [Përkthim] Po, kështu është.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
2 Prokurore, z. Prokuror, tani po ju drejtohem ju, që të
3 konfirmoni për procesverbal nëse nënshkrimet në faqet 11 dhe
4 23 në versionin anglisht -- ndërkohë i lutem Sekretares që ta
5 vendosi në ekran faqen përkatëse, pra, 11 anglishtja dhe 23
6 shqipja. A mund ta konfirmoni ju lutem për procesverbal se
7 nënshkrimet për marrëveshjen për pranimin e fajësisë janë
8 nënshkrime të përfaqësuesve të Zyrës së Prokurorit të
9 Specializuar?

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. E marrim parasysh.

13 Vazhdojmë.

14 Z. Bahtijari, po ju drejtohem sërish. Siç e dini dhe
15 sigurisht avokatja juaj e di, Trupi Gjykes mund ta miratojë
16 marrëveshjen për fajësinë siç keni rënë dakord me ZPS-në edhe
17 Avokatja në emrin tuaj nëse bindemi ne se janë mbushur kushtet
18 përkatëse. Kjo është e paraparë në rregullën 94(5) e
19 Rregullores.

20 Unë do ju bëj disa pyetje ju personalisht, do t'i bëj
21 pyetje Prokurorisë po edhe avokates suaj. Sa herë të jetë e
22 nevojshme që të verifikojmë ne se janë përmbushur të gjitha
23 kushtet e rregullës 94(5). Po filloj me rregullën 94(5)(a).

24 Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që e keni
25 nënshkruar personalisht thuhet se e keni diskutuar kushtet e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë mbi Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 10

1 kësaj marrëveshjeje me Avokaten tuaj dhe se e keni pranuar
2 marrëveshjen për pranimin e fajësisë pasi jeni konsultuar
3 mjaftueshëm me avokaten tuaj. Kjo thuhet në paragrafët 19, 24,
4 25 të parashtimit. Z. Bahtijari, a është vërtetë kështu?

5 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
7 e pohoni?

8 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
10 pohoni këtë, kështu ka ndodhur? Mirë. Shumë mirë.

11 Tani do flas për rregullën 94(5) (b) dhe (c). Do shkoj tek
12 kushtet e marrëveshjes në fjalë në mënyrë që Trupi Gjykes të
13 vlerësojë nëse ju vërtetë i keni kuptuar kushtet e
14 marrëveshjes për pranimin e fajësisë, jo vetëm që i kuptoni,
15 po që vërtetë të pajtoheni me kushtet e kësaj marrëveshjeje.

16 Z. Bahtijari, a e pohoni se e keni lexuar me kujdes
17 bashkë me avokaten tuaj çdo pjesë të marrëveshjes për pranimin
18 e fajësisë në një gjuhë që ju e kuptoni dhe se ju i kuptoni
19 kushtet e kësaj marrëveshjeje siç thuhet në paragrafin 24?
20 Mund të përgjigjeni?

21 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
23 e konfirmoni?

24 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

1 duam që ta thoni me fjalë që e kuptoni.

2 I AKUZUARI BAHTIJARI: E kuptoj. E kuptoj.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Gjuhën e ke kuptuar?

5 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe

7 kushtet i kupton.

8 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Flasim për rregullën 94(5)(c) që ka të bëjë me faktet që ju i

11 keni pranuar, z. Bahtijari, që janë në bazë të akuzave, që

12 qëndrojnë në bazë të akuzave që ka marrëveshja për pranimin e

13 fajësisë.

14 Do filloj me Shtojcën 1 të marrëveshjes ku janë faktet

15 për të cilat jeni pajtuar.

16 Z. Bahtijari, mund të qëndroni ulur gjatë kohës që lexoj

17 unë.

18 Është dokumenti me numër 628, për Sekretaren e Gjykatës

19 kjo, Shtojca 1, faqja 12. Në shqip është faqja 24.

20 Z. Bahtijari, duhet ta lexoj unë me zë këtë tekstin bazën

21 faktike për të cilën jeni pajtuar për të cilën keni rënë

22 dakord. Na ndiqni.

23 "I pandehuri Ismet Bahtijari pranon se ai ishte pjesë e

24 një grupi që kërkonte të nxiste Dëshmitarin 1 që të mos jepte

25 dëshmi para Dhomave të Specializuara të Kosovës përmes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë mbi Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 12

1 premtimit për përfitim. Në veçanti, anëtarët e grupit duke
2 vepruar nën drejtimin e Haxhi Shalën i shkuan Dëshmitarit 1 në
3 shtëpinë e tij, përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023. Gjatë
4 vizitës së 5 prillit, i pandehuri Ismet Bahtijari i tha
5 Dëshmitarit 1 se ai duhet të tërhiqte dëshminë e tij para
6 Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjatë vizitës së 12
7 prillit 2023, Sabit Januzi në vijim të vizitës së parë i
8 transmetoi Dëshmitarit 1 një ofertë që Haxhi Shala dhe të
9 tjerët do ta ndihmonin atë nëse ai e tërhiqte dëshminë e tij.
10 Para dhe pas vizitës më 5 prill 2023 dhe para vizitës së 12
11 prillit 2023 i pandehuri Ismet Bahtijari komunikoi dhe
12 koordinoi me anëtarët e tjerë të grupit për ndërveprimet e
13 tyre me Dëshmitarin 1.”

14 Z. Bahtijari, a e konfirmoni marrëveshjen tuaj mbi bazën
15 faktike për të cilën keni rënë dakord siç ua lexova unë,
16 pajtoheni me këtë?

17 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

19 Z. Bahtijari, për ta -- meqë marrëveshja për pranimin e
20 fajësisë përmend edhe disa pjesë që Aktakuzës, unë do t'ju
21 lexoj paragrafët përkatës nga Aktakuza e Konfirmuar e 10
22 korrikut 2024, bëhet fjalë për paragrafët 8, 9, 13 dhe 18 dhe
23 24(i), (ii) dhe (iii). Dhe i lutem Sekretares të vendosë në
24 ekran versionin publik të Aktakuzës së Konfirmuar të datës 10
25 korrik 2024 që mban numrin 379, Shtojca 3, ju lutem dhe në

1 anglisht edhe në shqip.

2 Do ta lexoj me zë, z. Bahtijari, paragrafin përkatës,
3 pra, paragrafët që i përmenda, që përmendëm në paragrafin 5 të
4 marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Po i përsërisë dhe një
5 herë për Sekretarinë, bëhet fjalë për paragrafët 8 dhe 9, 13
6 deri në 18 dhe 24 nënparagrafët (i), (ii) dhe (iii).

7 Në rregull. I lutem Sekretares të shohim fillimisht
8 paragrafin 8 në të dyja versionet, ju lutem.

9 Z. Bahtijari, e sheh në ekran paragrafin 8 dhe 9 që po
10 tregohet këtu me shenjë?

11 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë. Po i lexoj atëherë.

14 "Më 5 prill 2023 ..."

15 Paragrafi 8 ky.

16 "Më 5 prill 2023, Shala i telefonoi Januzit. Më pas edhe
17 Bahtijari i telefonoi Januzit."

18 Shkojmë në paragrafin 9:

19 "Pasi i telefonoi dhe u sigurova që Dëshmitari 1 ishte në
20 shtëpi, Bahtijari shkoi në shtëpinë e Dëshmitarit 1. Bahtijari
21 i tha Dëshmitarit 1 se Shala e kishte kontaktuar kohët e
22 fundit dhe e kishte dërguar që t'i thoshte Dëshmitarit 1 se
23 duhej të tërhiqte dëshminë."

24 Ju lutem të shkojmë në paragrafin 13 tani në të dyja
25 versionet. Do lexoj deri në paragrafin 18. Pak më lart në

1 tekst. Ju lutem që të kaloni faqen kur të shkojmë në
2 paragrafin përkatës. Më saktë kur të jem tek paragrafi 16 do
3 ju kërkoj të kalojmë në faqen tjetër. Mirë pra.

4 Paragrafi 13:

5 "Më vonë, më 5 prill 2023, pasi Bahtijari kishte vizituar
6 Dëshmitar 1, Shala dhe Januzi si dhe veçmas Januzi dhe
7 Bahtijari, patën kontakte të shumta me mesazhe dhe telefon ku
8 përfshihen edhe kontaktet midis Shalës dhe Januzit për
9 bashkërendimin e një takimi personal atë natë, po atë natë.

10 "Gjatë ditëve në vijim, Shala dhe Januzi, ndër të tjerë,
11 mbetën në kontakt dhe u lidhën përmes telefonit së paku katër
12 herë mes 6 prillit dhe 9 prillit 2023."

13 Paragrafi 15 tani:

14 "Më 12 prill pak pasi i kishte telefonuar Shalës, Januzi
15 shkoi në shtëpinë e Dëshmitarit 1. Në shtëpinë e Dëshmitarit
16 1, Januzi i tha Dëshmitarit 1 se Shala i kishte kërkuar
17 Januzit të vinte aty në vijim të vizitës së Bahtijarit për të
18 mësuar se çfarë planifikonte të bënte Dëshmitari 1 dhe si mund
19 të zgjidhej çështje e dëshmisë së tij."

20 Paragrafi 16:

21 "Konkretisht, Januzi i tha dëshmitarit 1 se Shala i
22 kishte kërkuar Januzit që të përcillte mesazhin se nëse
23 Dëshmitari 1 do të tërhiqte dëshminë, atëherë Shala dhe
24 persona të tjerë të papërmendur me emra do t'i ofronin
25 'ndihmë'. Dëshmitari 1 u përgjigj se në qoftë se Shala

1 dhe/ose të tjerët do t'i jepnin atij 200.000 euro do të
2 arrihej ujdia.”

3 Shkojmë në paragrafin 17. Faleminderit.

4 “Dëshmitari 1 nuk e konfirmoi apo mohoi se ishte
5 dëshmitar. Januzi tha që do t'u tregonte 'atyne' se çfarë
6 kishte thënë Dëshmitari 1.”

7 Paragrafi 18:

8 “Pak pas vizitës së 12 prillit 2023 që i bëri Dëshmitarit
9 1, Januzi i telefonoi sërish Shalës.”

10 Tani shkojmë në paragrafin 24, ju lutem.

11 Paragrafi 24 edhe nënparagrafët përkatës, (i):

12 “Më 5 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Bahtijari
13 kontaktoi Dëshmitarin 1 dhe i tha Dëshmitarit 1 se Dëshmitari
14 1 duhet të tërhiqte dëshminë në proceset e DHSK-së.

15 “Dhe më 12 prill 2023, me udhëzim të Shalës, Januzi
16 kontaktoi Dëshmitarin 1 në vijim të kontaktit të mëhershëm të
17 Bahtijarit për t'i komunikuar dëshmitarit ofertën se Shala se
18 persona të tjerë të papërmendur me emra do ta ndihmonin
19 Dëshmitarin 1 nëse ai pranonte të tërhiqte dëshminë e tij.”

20 Dhe nën paragrafi i fundit:

21 “Para dhe pas kontakteve të tyre me Dëshmitarin 1, Januzi
22 dhe Bahtijari komunikuan dhe bashkërenduan me njëri-tjetrin
23 dhe me Shalën.”

24 Kjo ishte përmbajtja e paragrafëve në Aktakuzën e
25 Konfirmuar të 10 dhjetorit 2024.

1 Tani do shohim paragrafin 5 të marrëveshjes për pranimin
2 e fajësisë ku thuhet si në vijim:

3 "Ismet Baftijari dhe Prokuroria pajtohen se " --

4 Faleminderit, Sekretares, presim të na e vendosin në
5 ekran, ju lutem, të shohim paragrafin 5 në ekran.

6 "Ismet Bahtijari dhe Prokuroria pajtohen që nëse
7 Prokuroria do të bënte paraqitjen e provave, atëherë faktet
8 dhe akuzat e përcaktuara në paragrafët 8, 9, 13 deri në 18 dhe
9 24, nënparagrafët i(i), ii dhe iii) të Aktakuzës të datës 10
10 korrik 2024, do të vërtetoheshin jashtë dyshimit të arsyeshëm
11 dhe se ato fakte janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk
12 kundërshtohen nga Ismet Bahtijari."

13 Z. Bahtijari, tash po të drejtohem ty. A e konfirmon se
14 je pajtu me këtë deklaratë që posa ta lexova, a e konfirmon
15 këtë?

16 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, e konfirmoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit shumë.

19 Tash do të kalojmë tek pjesa e natyrës të akuzave.

20 Z. Bahtijari, Trupi Gjykses gjithashtu dëshiron të
21 sigurohet se i kupton plotësisht akuzat e përfshira në
22 marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe prandaj do t'i lexoj
23 për ty paragrafët 3, 8 dhe 9 të marrëveshjes për pranimin e
24 fajësisë.

25 Faleminderit, znj. Sekretare i kemi në ekran paragrafët

1 përkatës në të dy gjuhët.

2 Paragrafin 3 aty ku është shigjeta thuhet, a e shikoni z.
3 Bahtijari, aty ku është shigjeta te 3?

4 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 "Ismet Bahtijari bie dakord të pranojë fajin para Trupit
7 Gjykses në përputhje me rregullën 94 të Rregullores në lidhje
8 me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës të datë 10 korrik
9 2024, në masën që ata pretendojnë në Pikën Dy (2), pengim të
10 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë
11 pjesë në aksionin e përbashkët të një grupi midis më së paku 5
12 prillit dhe 12 prillit 2023, e ndëshkueshme sipas Kodit Penal
13 të Kosovës, shkurtimisht ('KPK'), nenet 17, 21, 28, 33, 35 dhe
14 401(2) dhe (5) dhe nenet 15(2) dhe neni 16(3) të ligjit për
15 Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar,
16 shkurtimisht ('Ligji') dhe në Pikën Tre (3), frikësim gjatë
17 procedurave penale me anë të premtimit për dhuratë ose çfarëdo
18 forme tjetër përfitimi midis më së paku 5 prillit dhe 12
19 prillit 2023, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 31, 33, 35
20 dhe 387 të Kodit Penal të Kosovës dhe neneve 15(2) dhe 16(3)
21 të Ligjit, duke përfshirë të gjitha mënyrat e përgjegjësisë të
22 pretenduara në të."

23 Në paragrafin 8 të marrëveshjes thuhet - a e shikoni
24 përpara jush, z. Bahtijari, aty shigjeta te 8?

25 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 "Ismet Bahtijari e kupton plotësisht se ai po e pranon
3 fajësinë në lidhje me Pikat Dy (2) dhe Tre (3) të Aktakuzës,
4 sikurse përshkruhen më lart dhe konkretisht pranon sjelljen e
5 tij të përcaktuar në paragrafët 8, 9, 13 deri në 18 dhe 24,
6 (nënparagrafët i(i), ii dhe iii) të Aktakuzës dhe siç
7 përshkruhet më tej në bazat faktike të rëna dakord."

8 Tash do të shkojmë tek paragrafi 9, te numri 9 është pak
9 më i gjatë dhe aty thuhet kështu:

10 "Ismet Bahtijari e kupton se nëse do të zhvillohej një
11 gjykim, Prokurorisë do t'i kërkohej të provonte elementët e
12 mëposhtëm të neneve 21, 387, 401(2) dhe (5), jashtë dyshimit
13 të arsyeshëm."

14 Dhe elementet në lidhje me Pikën Dy (2), janë si vijon:

15 "(a) Pjesëmarrja në një grup personash, i cili përmes
16 veprimit të përbashkët neni 401(2) i Kodit Penal të Kosovës
17 pengon ose tenton të pengojë person zyrtar në kryerjen e
18 detyrave zyrtare." Neni 401(2) i Kodit Penal të Kosovës.

19 "(c) Vepra penale është kryer ndaj një gjyqtari,
20 prokurori, zyrtari të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë ose
21 ndaj një personi të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria ose
22 ndaj një oficeri policie në kryerjen e detyrave të tyre
23 zyrtare." Neni 401(5) e 401(2) i Kodit Penal të Kosovës.

24 "(d) Vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin ose vetëdija
25 se një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit

1 ose mosveprimit dhe bashkimit në ndodhjen e tij." Dhe ky është
2 neni 21 i Kodit Penal të Kosovës.

3 Tash të kalojmë te Pikën 3 dhe elementet e kësaj pike:
4 Nen (a):

5 "Përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë ose ndonjë
6 mënyre tjetër detyrimi, premtimi për dhuratë ose në ndonjë
7 formë tjetër përfitimi", është neni 387 i Kodit Penal të
8 Kosovës.

9 (b) "Nxitja e një personi tjetër që të mos japë
10 deklaratë ose të jepte deklaratë të rreme ose të mos jepte
11 informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit dhe
12 ky informacion ka të bëjë me pengimin e procedurës penale."
13 Dhe ky është neni 387 i Kodit Penal të Kosovës.

14 Dhe elementi i fundit nën (c):

15 "Vetëdija dhe dëshira për të kryer aktin ose vetëdija se
16 një pasojë e ndaluar mund të ndodhë si rezultat i veprimit ose
17 mosveprimit dhe bashkimi në ndodhjen e këtij." Neni 21 i Kodit
18 Penal të Kosovës.

19 Z. Bahtijari, përsëri po ju drejtohem ju, a konfirmoni se
20 jeni pajtu me këto akuza?

21 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Tani sa i përket pranimit të fajit, i referohem
25 paragrafëve 7 dhe 3 të marrëveshjes do të lexoj paragrafin 7

1 por edhe 3, që posa ua lexova, por lidhet edhe me këtë
2 kontekst.

3 Pra, do të filloj tek paragrafi 7 i marrëveshjes. A
4 shikoni, z. Bahtijari, në ekran nga ana e majtë aty ku është
5 shigjeta?

6 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tash
8 do t'ua lexoj këtë paragraf:

9 "Ismet Bahtijari bie dakord të pranojë fajësinë në lidhje
10 me akuzat e identifikuara në paragrafin 3 më lartë sepse ai në
11 fakt është fajtor dhe e pranon fajin e tij dhe pranon
12 përgjegjësinë e plotë për sjelljes e tij sikurse përshkruhet
13 në bazën faktike të rënë dakord."

14 Z. Bahtijari, a e konfirmoni pajtimin tuaj në lidhje me
15 këtë pikë?

16 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Z. Bahtijari, merr shënim pajtimin tuaj dhe zyrtarisht do
20 t'ju kërkoj të bëni vetëdeklarimin ma vonë gjatë kësaj seance.

21 Tani do të kaloj tek dënimi.

22 Znj. Sekretare, a mund të shkojmë te paragrafi 11.

23 Sa i përket dënimit, z. Bahtijari, në paragrafin 11 të
24 marrëveshjes për pranimin e fajësisë, se ju pajtoheni me
25 përcaktimin e një dënimi me burg prej 2 vjetësh.

1 Z. Bahtijari, a konfirmoni se pajtoheni me caktimin e një
2 dënimi me dy vjet burgim?

3 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit.

6 Tani kam një pyetje për Avokaten Mbrojtëse në versionin e
7 mëparshëm të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në
8 paragrafin 10 të atij parashtrimi me numër 618, Shtojca 3 të
9 datës 6 dhjetor 2024, z. Bahtijari u pajtua me caktimin e një
10 dënimi deri më dhe duke përfshirë 10 vjet burgim.

11 Znj. Sekretare, a mund ta vendosim në ekran këtë
12 dokument, por jo për publikun.

13 Kërkoj falje që ju lashë në këmbë avokate, na duhet vetëm
14 pak kohë.

15 Sikurse thashë, në marrëveshjen për pranimin e fajësisë
16 këtë të fundit, z. Bahtijari, pajtohet me caktimin e një
17 dënimi prej dy vjetësh. A mund të na e shpjegoni këtë dallim
18 midis këtyre viteve?

19 ZNJ. GERRY [Përkthim] Në marrëveshjen e mëparshme, ne nuk
20 u pajtuam me dhjetë vjet. Ne u pajtuam me atë që tha
21 Prokuroria se shkallëzimi i dënimit është prej 0 deri në 10
22 vjet dhe pastaj Prokuroria bëri rekomandimin për një dënim
23 prej dy vjetësh burgim.

24 Marrëveshja aktuale përmban marrëveshjen midis nesh për
25 dy vjet burgim. Marrëveshja e mëparshme ka përdorur gjuhë

1 specifike për t'ju referuar Kodit Penal të Kosovës që lejon që
2 kjo Gjykatë të shkojë edhe më poshtë minimumit ligjor prej dy
3 vjetësh për dënim me burg. Domethënë, në marrëveshjen e
4 mëparshme u bë një përpjekje që të përfshihej edhe kjo
5 marrëveshje, mirëpo në marrëveshjen e tashme është bë, palët
6 kanë rënë dakord për dy vjet sikurse parashikohet në rregullën
7 94 të kësaj Gjykate.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit. Për momentin mjafton kaq.

10 Z. Bahtijari, kam dy pyetje për ju. Dhe ju mund të
11 konsultoheni me Avokaten përpara se të përgjigjeni, në qoftë
12 se dëshironi.

13 A mund të më konfirmoni se keni qenë i informuar
14 plotësisht se Trupi Gjygues nuk do të marrë vendim sot për
15 marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke përfshirë edhe për
16 dënimin edhe pse është dorëzuar kjo marrëveshje, domethënë, a të
17 ka informuar Avokatja se sot Trupi Gjygues nuk do të marrë
18 vendim në lidhje me marrëveshjen dhe dënimin?

19 Dhe pyetja e dytë, a konfirmoni se ju pajtoheni me
20 caktimin e një dënimi me dy vjet burgim në përputhje me
21 marrëveshjen për pranimin e fajësisë që është nënshkruar këtë
22 javë?

23 E keni fjalën, z. Bahtijari.

24 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

1 keni rolin që të mbroni interesat e klientit tuaj dhe e çmoj
2 ndërhyrjen tuaj.

3 Z. Bahtijari, në marrëveshjen për pranimin e fajësisë
4 gjithashtu thuhet në paragrafin 16 se në shkëmbim të pranimit
5 të fajësisë, ZPS-ja do të rekomandojë para Trupit Gjykues një
6 dënim prej dy vjetësh burgim dhe do të rekomandojë që të
7 merret parasysh koha që deri tash keni kalu në paraburgimin e
8 Dhomave të Specializuara të Kosovës.

9 Në përputhje me paragrafin 16(c) të kësaj marrëveshjeje,
10 ZPS-ja gjithashtu pajtohet që ta tërheqë Pikën 1 të Aktakuzës
11 kundër jush.

12 A e konfirmoni këtë, z. Bahtijari?

13 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Tani do të kaloj te paragrafi 12 i marrëveshjes për
17 pranimin e fajësisë, që ka të bëjë me mjetet ligjore apo
18 mjetet ndreqëse.

19 Faleminderit, znj. Sekretare, për vendosjen e dokumentit
20 në ekran. Të shkojmë tek paragrafi 12, pra, tek paragrafi 12 i
21 parashtrimit 628, Shtojca 1 që është marrëveshja për pranimin
22 e fajësisë.

23 Sa u përket mjeteve juridike, z. Bahtijari, unë do ta
24 lexoj pjesën e nevojshme, në paragrafin 12 dhe 16 të
25 marrëveshjes që ka të bëjë me mundësinë e apelimit të vendimit

1 të fajësisë dhe dënimit.

2 Paraprakisht, dua të theksoj se ZPS-ja ka tërheqë
3 kërkesën për rishqyrtimin e vendimit 612 dhe për leje për të
4 apeluar atë vendim dhe kjo kërkesë për tërheqjen e kërkesës
5 është parashtrimi 631 i datës 17 dhjetor. Si rezultat i kësaj,
6 paragrafi 12 i marrëveshjes për pranimin e pafajësisë do
7 ndryshohet për ta reflektuar këtë ndryshim në 612. Trupi
8 Gjykues do të nxjerrë urdhrin përkatës në kohën më vonë.
9 Gjithashtu dua t'ju sigurojë se ju duhet ta kuptoni si ndikon
10 kjo në marrëveshjen tuaj për pranimin e fajësisë. Ju,
11 gjithashtu, mund të konsultoheni me Avokatin tuaj përpara se
12 të përgjigjeni.

13 Përveç kësaj, në bazë të kushteve të paragrafit 12 të
14 kësaj marrëveshjeje, dua t'ju informoj ose prej jush të kërkoj
15 të konfirmoni që ju nuk do të merrni hap për ta tërheqë
16 vetëdeklarimin e fajësisë apo për ta apeluar vendimin bazë të
17 vetëdeklarimit të fajësisë.

18 Z. Bahtijari, a e keni të qartë dhe a pajtoheni se në
19 qoftë se Trupi Gjykues do ta miratojë marrëveshjen për
20 pranimin e fajësisë dhe do të caktojë një dënim që përputhet
21 me kushtet e asaj marrëveshjeje, ju nuk do të keni të drejtë
22 që të bëni apelim kundër vendimeve përkatëse dhe se ju nuk do
23 të tërhiqni vetëdeklarimin e fajësisë dhe nuk do të apelonit
24 vendimin për fajësinë tuaj në bazë të marrëveshjes?

25 Dua prej jush që të konfirmoni se i keni të qarta të dyja

1 këto pika që ua vuna në dije, z. Bahtijari edhe një herë po ju
2 them se përpara se të përgjigjeni mund të konsultoheni me
3 Avokaten tuaj. Po, e keni fjalën z. Bahtijari, mund të
4 përgjigjeni.

5 I AKUZUARI BAHTIJARI: Edhe një herë nëse bën pyetjen, se
6 s'e kuptova.

7 ZNJ. GERRY [Përkthim] Ndoshta mund të ndihmoj unë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
9 mund të konsultoni klientin dhe kemi procedurë për këtë, po
10 unë thjesht preferoj që unë t'i bëj pyetjet dhe ai të
11 përgjigjet.

12 ZNJ. GERRY [Përkthim] Me leje, unë do të kisha kërkuar
13 prej jush që t'i ndani pyetjet një nga një. Sepse ju bëtë disa
14 pyetje me radhë. Pyetja e parë është ishte në qoftë se ai do
15 të tërhiqte ose jo vetëdeklarimin e fajësisë dhe pyetja e dytë
16 kishe të bënte me të drejtën e apelit, domethënë, që nuk ka të
17 drejtë ta apelojë atë vendim.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
19 këtë t'ia shpjegoni atij, pra, keni të drejtë t'ia shpjegoni
20 këtë klientit tuaj.

21 ZNJ. GERRY [Përkthim] Në rregull. Unë thjesht kërkoj që
22 pyetja të ndahet në dy pjesë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne
24 mund të vazhdojmë ashtu, mirëpo këto nuk ndahen njëra prej
25 tjetrës dhe mjafton për tash.

1 ZNJ. GERRY [Përkthim] Besoj se pasi më ka ndëgju mu do ta
2 ketë ma të qartë z. Bahtijari se janë dy pyetje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Bahtijari, do ta përsëriti pyetjen.

5 A e ke të qartë edhe pajtohesh se në qoftë se Trupi
6 Gjykes, Gjykatësit e miratojnë marrëveshjen për pranimin e
7 fajësisë që e ke bë dhe e caktojnë dënimin në përputhje me atë
8 marrëveshje që është bë, ti nuk do të apeloosh vendimin dhe nuk
9 do të kërkosh mjet juridik në lidhje me atë vendim dhe e dyta
10 në qoftë se e ke të qartë dhe pajtohesh se nuk do ta tërheqësh
11 deklarin e fajësisë dhe nuk do të apeloosh vendimin e
12 fajësisë në përputhje me marrëveshjen që ke bë për pranimin e
13 fajësisë?

14 I AKUZUARI BAHTIJARI: Jo.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
16 nuk e kuptoj apo?

17 I AKUZUARI BAHTIJARI: Jo, jo nuk i bëj ato sene.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
19 atëherë.

20 I AKUZUARI BAHTIJARI: S'e merr vesht.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga
22 ana e ZPS-së, vë në dukje paragrafin 16 të marrëveshjes për
23 pranimin e fajësisë. Dhe të gjitha komentet paraprahe vlejné
24 edhe për paragrafin 16(b) (i) të marrëveshjes për sa i përket
25 ndryshimeve.

1 Z. DEVANEY: [Përkthim] Kemi parasysh këtë që thatë, e
2 nderuar Gjykatëse.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Z. Bahtijari, tash do të kalojmë te rregulla 94(5)(c), si
5 mbas së cilës Trupi Gjygues duhet të bindet se e keni bërë
6 marrëveshjen për pranimin e fajësisë me vullnetin të lirë, Z.
7 Bahtijari. Dhe theksoj se në paragrafin 24 të marrëveshjes --
8 znj. Sekretare të shkojmë tek ky paragraf te dokumenti në
9 ekran. Faleminderit.

10 Aty, pra, numri 24, thuhet se "askush nuk më ka kërcënuar
11 apo detyruar në asnjë mënyrë për të bërë këtë marrëveshje. Unë
12 e kam bërë këtë marrëveshje lirisht dhe vullnetarisht".

13 Avokatja juaj në paragrafin 19 - të shkojmë te paragrafi
14 19 - avokatja thotë se e keni bërë këtë marrëveshje "lirisht,
15 vullnetarisht" dhe se nuk janë bërë kurrfarë kërcënimesh dhe
16 se të vetmet premtime që të janë bërë janë ato të përcaktume në
17 këtë marrëveshje.

18 Z. Bahtijari, a mund t'i konfirmoni para Gjykatësve se
19 jeni pajtuar me këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë
20 vullnetarisht, pa kurrfarë kërcënimi apo mënyre tjetër
21 shtrënguese?

22 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, e konfirmoj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Tash do të kalojmë tek pika e radhës. Trupi Gjygues

1 dëshiron të konfirmojmë se ju, z. Bahtijari, i keni të qarta,
2 i kuptoni pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe
3 se hiqni dorë prej të drejtës për t'u gjykuar me një
4 procedurës të rregullt sipas rregullës 94(5) të Rregullores.

5 Në lidhje me këtë pikë, z. Bahtijari, ka disa hapa dhe do
6 t'i kaloj këto hapa bashkë ëme ju.

7 Më së pari, do ta lexoj paragrafin 17(a) deri te shkronja
8 (f) dhe paragrafët 18(a) dhe (b) të marrëveshjes për pranimin
9 e fajësisë, në këto paragrafë paraqitet një përmbledhje e të
10 drejtave prej të cilave ke heq dorë dhe të drejtat që ende të
11 takojnë.

12 Z. Bahtijari, me anë të kësaj marrëveshjeje do t'ju
13 jipen, pjesërisht ose plotësisht, mundësitë për të ushtruar të
14 drejtat e mëposhtme.

15 (a) Është e drejta për t'u vetëdeklaruar i pafajshëm dhe
16 për t'i kërkuar Prokurorisë që t'i vërtetojë akuzat në
17 Aktakuzë jashtë dyshimit të arsyeshëm në një gjykim të drejtë
18 dhe të paanshëm;

19 E drejta për t'u gjykuar në praninë tuaj dhe i
20 përfaqësuar nga një mbrojtës i specializuar në gjykim;

21 E drejta për të paraqitur mbrojtjen dhe arsyet që
22 përjashtojnë përgjegjësinë penale, si dhe për të paraqitur
23 prova të pranueshme në Aktgjykim, pa shkaktuar dëm së drejtave
24 për të bërë parashtime dhe prova ekzistuese;

25 Dhe e drejta për të marrë në pyetje ose që të merren në

1 pyetje prej dikujt tjetër në emrin tuaj dëshmitarë kundër
2 jush, për të siguruar pjesëmarrjen, marrjen në pyetje të
3 dëshmitarëve në emrin tuaj, në të njëjta kushte si dëshmitarët
4 kundër jush, pa paragjykuar ushtrimin e së drejtës për të
5 marrë në pyetje çdo dëshmitar që mund të thirret për të
6 dëshmuar dhe të drejtën tuaj për të thirrur dëshmitarë dhe për
7 t'i marrë ata në pyetje në emrin tuaj në çdo procedurë lidhur
8 me dënimin.

9 Mandej te pika (f):

10 E drejta për të ndjekur mjetet ligjore të apelimit lidhur
11 me dënimin apo vendimin e dënimit siç është përcaktuar në
12 paragrafin 12, që sapo ua lexova.

13 Z. Bahtijari, a mund të konfirmoni se e kuptoni këtë dhe
14 hiqni dorë prej këtyre të drejtave?

15 I AKUZUARI BAHTIJARI: E konfirmoj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull. Faleminderit.

18 E dyta, sipas kushteve të marrëveshjes për pranimin e
19 fajësisë dhe këtu janë paragrafi 18(a) dhe (b) - faleminderit,
20 znj. Sekretare - kuptohet se i ruani të gjitha të drejtat e
21 tjera, duke përfshirë, në veçanti:

22 (a) Të drejtën për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës i
23 specializuar në të gjitha fazat së procedurës dhe për të
24 komunikuar lirshëm me një mbrojtës të tillë në mirëbesim; dhe

25 (b) Të drejtën për të paraqitur çdo informacion ose provë

1 relevante për përcaktimin e dënimit përfshirë edhe masat
2 lehtësuese në përputhje me rregullën 162(1) dhe (5) të
3 Rregullores.

4 Përpara se t'i drejtohem, z. Bahtijari, për ta pyetur se
5 a i kupton pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe
6 heqjen dorë të drejtës për t'u gjykuar në procedurë të
7 rregullt, dua që t'i jap mundësi Zyrës së Prokurorit dhe
8 Mbrojtjes të bëjnë parashtrime në qoftë se kanë, duke përfshi
9 edhe në lidhje me rregullën 94(5) (e) dhe (f).

10 Z. DEVANEY: [Përkthim] Duket pas dëgjimit të gjithë
11 ndërhyrjeve, shkëmbimet, parashtrimi i Prokurorisë është që
12 parakushtet në nënregullën 94(5) janë plotësuar, përfshirë
13 nënpikën (e) dhe (f). Dhe ZPS-ja nuk ka as komente të tjera
14 lidhur me këtë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Mbrojtësja.

17 ZNJ. GERRY [Përkthim] Pajtohem dhe nuk kemi parashtrime
18 në këtë pikë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Bahtijari, a mund t'ju kërkoj që të konfirmoni përsëri pasi
21 dëgjuat që Prokuroria dhe avokati juaj nuk ka parashtrime
22 shtesë, a mund të konfirmoni edhe një herë që kuptoni kushtet
23 dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe që nuk
24 dëshironi të ndryshoni asgjë në marrëveshjen për pranimin e
25 fajësisë që e keni nënshkru?

1 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, e konfirmoj.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Tani do t'ju kërkoj që të ngriheni në këmbë. Dhe do t'ju
5 kërkoj që të ndryshoni vetëdeklarimin fillestar.

6 Gjatë seancave të 9 tetorit dhe 12 korrikut 2024, jeni
7 vetëdeklaruar i pafajshëm për akuzën e pengimin të personit
8 zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë pjesë në
9 veprim në grup në Pikën 2 në Aktakuzës së Konfirmuar të datës
10 4 tetorit 202, parashtrimi i protokolluar 10 dhe akuza e
11 frikësimit gjatë procedurës penale sipas akuzës 3 të Aktakuzës
12 së Konfirmuar të 10 korrikut 2024, parashtrimi i protokolluar
13 379, Shtojca 1, përkatësisht.

14 A jeni gati të ndryshoni vetëdeklarimin fillestar tuajin?

15 I AKUZUARI BAHTIJARI: Nuk po e kuptoj pyetjen. Edhe një
16 herë?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
18 kuptoj këtë. Po gjatë seancave që kemi bë para një viti, më
19 shumë se një vit, ju jeni deklaruar i pafajshëm për akuzat. Tani
20 po ju pyes që a do të deklaroheni fajtor, domethënë, a jeni
21 gati ta ndryshoni këtë vetëdeklarim?

22 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
24 keni vështirësi të qëndroni në këmbë, mund të uleni.

25 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po e ndërroj.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Faleminderit. Tani do të lexoj Pikën 2 dhe 3 në Aktakuzën e
3 Konfirmuar të 10 korrikut 2024, dhe do t'ju kërkoj që të
4 vetëdeklaroheni, pra, lidhur me secilën prej këtyre pikave.

5 Z. Bahtijari, mund të uleni.

6 Pika 2: Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
7 detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e
8 përbashkët të një grupi, midis më së paku 5 dhe 12 prillit
9 2023, vepër penale kundër rendit publik, e ndëshkueshme në
10 bazë të neneve 17, 21, 28, 33, 35 dhe 401(2) dhe (5) të Kodit
11 Penal të Republikës së Kosovës të vitit 2019 dhe nenet 15(2)
12 dhe 16(3) të Ligjit.

13 Lidhur me këtë pikë të akuzës, z. Bahtijari, si
14 deklarojeni, fajtor apo i pafajshëm?

15 I AKUZUARI BAHTIJARI:: Fajtor.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Tani do të lexoj Pikën 3: Frikësim gjatë procedurës
19 penale, midis më së paku 5 dhe 12 prillit 2023, vepër penale
20 kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike,
21 e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 21, 31 33, 35 të Kodit
22 Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit 387 dhe nenet 15(2),
23 16(3) të Ligjit.

24 Z. Bahtijari, si deklarojeni për këtë akuzë, fajtor apo i
25 pafajshëm?

1 I AKUZUARI BAHTIJARI: Fajtor.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
3 rregull.

4 Vazhdojmë tema e zhdëmtimit.

5 Trupi Gjykes ju drejtohet juve tani, Avokate Mbrojtëse,
6 në qoftë se keni ndonjë koment lidhur me këtë pikë.

7 ZNJ. GERRY [Përkthim] Kemi bërë disa komente me shkrim që
8 nuk duhet të ketë kosto financiare sa i takon z. Bahtijari dhe
9 kjo, këtu përfshihet, pra, çdo gjobë e mundshme apo për
10 shpenzime të procedurës apo zhdëmtime. Duke patur parasysh
11 urdhrin me gojë që ju dhatë dje, znj. Gjykatëse, që mund të
12 bëhen hetime apo kërkime lidhur me viktimat e mundshme nëse ka
13 ndonjë viktimë që kërkon zhdëmtime dhe në të cilat raste këto
14 zhdëmtime mund të jenë të zbatueshme, ne pranojmë që ju keni
15 kërkuar që të bëhet një hetim i tillë. Ju keni dhënë këtë
16 urdhër gojor për këtë çështje. Dhe nuk mund të bëjmë
17 parashtrime të plota lidhur me zhdëmtimin derisa të bëhet ky
18 hetim që ju keni urdhëruar.

19 Po ajo që mund të themi është që në parashtrimet tona
20 paraprahe, ne parashtrojmë që lidhur me çështjen e zhdëmtimeve
21 në momentin që, pra, të plotësohet, parashtrimet tona do t'i
22 bëjmë të plota në momentin që urdhri i lëshuar nga ju do të
23 zbatohet.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit. Kjo e bën të qartë siç edhe ju, ju keni bërë

1 parashtrime lidhur me ndëshkime financiare dhe se nuk duhet të
2 ketë pasoja financiare, siç e thatë juve, por ne nuk shohim
3 qartësisht ndonjë gjë në parashtrimet tuaja sa i përket
4 zhdëmtimeve. Paragrafi 15, në qoftë se nuk jam gabim, është
5 marrëveshja për pranimin -- gjithçka është, pra, në
6 marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe do të trajtohet në
7 moment tjetër.

8 Desha thjesht të sigurohem që e keni kuptuar të gjitha.

9 ZNJ. GERRY [Përkthim] Faleminderit. Në këtë fazë nuk kemi
10 asgjë tjetër për shtuar. Uroj që të jem në gjendje t'ju
11 ndihmoj kur të arrini në këtë pikë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Zyra e Prokurorit të Specializuar.

15 Z. DEVANEY: [Përkthim] Ne kemi shumë pak për të shtuar
16 marrëveshjes. Parashtrimet do të ishin tepër të hershme në
17 këtë fazë, nuk e dimë a ka viktimë, viktimë që marrin pjesë,
18 pra, pjesëmarrëse dhe ne dhe një herë presim zbatimin e
19 urdhrit gojor që keni dhënë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Kalojmë tek pjesa e dënimit.

23 Trupi Gjykes vëren në parashtrimet e shkruara të palëve
24 lidhur me dënimin. Përpara që t'ju jap fjalën palëve, pra,
25 Mbrojtjes dhe Prokurorit, do kërkoj një sqarim nga Avokatja

1 Mbrojtëse pastaj do të kemi kohë për parashtrime tjera.

2 Znj. Avokate, z. Bahtijari konfirmoi më herët sot se
3 pajtohet për caktimin, dhënien e një dënimi prej dy vitesh
4 burg dhe sipas paragrafit 11 të marrëveshjes për pranimin e
5 fajësisë kështu jemi tani. A mund të na qartësoni qëndrimin e
6 Mbrojtjes siç u shpreh dje në Gjykatë gjatë takimit të
7 çështjeve paraprake dhe po ju citoj, do t'ju jap edhe
8 referencat e sakta:

9 "... qëndrimi i z. Bahtijari është që ai duhet të lirohet
10 menjëherë dhe çdo vonesë tjetër do të dëmtonte atë."

11 Dhe ky qëndrim është shprehur edhe në parashtrimet tuaja
12 për dënimin parashtrimi 620, paragrafi 70, i 6 dhjetorit 2024,
13 është parashtrim i protokolluar konfidencial.

14 Gjykata do të dijë nëse mund të sqaroni pak më shumë, të
15 arsyetoni qëndrimin tuaj.

16 ZNJ. GERRY [Përkthim] Kërkoj ndjesë në qoftë se e kam
17 formuluar gabim dje. Ne nuk po kërkojmë më shumë sesa
18 marrëveshja për pranimin e fajësisë, urojmë që gjatë ushtrimit
19 të kompetencave tuaja ekskluzive që kemi parashtrimet tona të
20 merren parasysh në favor tonin për sa i përket dënimit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit, znj. Avokate. Do t'ju jap fjalën tani në qoftë
23 se keni parashtrime të tjera. I kemi konstatuar dhe
24 parashtrimet me shkrim. Fjalën e keni ju në qoftë se keni
25 parashtrime të tjera, znj. Avokate.

1 ZNJ. GERRY [Përkthim] Sa të sistemohem pak me letrat dhe
2 nuk do t'ju marr shumë kohë, por kam disa çështje që desha të
3 paraqes para Gjykatës me gojë.

4 Për shkak të natyrës së disa materialeve do të kërkoja që
5 të kalojmë në seancë private. Dhe në mënyrë që të jem në
6 gjendje të bëjë parashtrime të plota pa ju referuar
7 materialeve konfidenciale.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
9 kalojmë në seancë private dhe pastaj do t'ju kërkoj të më
10 shpjegoni pse gjithë seanca në tërësi duhet të jetë në seancë
11 private.

12 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, znj. Sekretare.

21 ZNJ. GERRY [Përkthim] Unë mbështes fjalët që z. Prokurori

22 Devaney na përmendi dje. Sipas parashtrimit tonë z. Bahtijari

23 nuk është as fillimi, as mesi, as fundi i kësaj shkeljeje apo

24 vepre penale, por është niveli më i ulët që mund të kemi i

25 fajësisë pra.

1 E kam përmendur gjendjen e tij shëndetësore në
2 Konferencën për Ecurinë e Çështjes publike në mars të vitit
3 2021 dhe ju ftoj të gjithëve të lexoni këtë përfundim. Ai
4 është i varfër, i sëmurë, njeri burrë i vjetër, më i vjetër
5 sesa vitet që ka në të vërtetë, i cili ka vepruar sipas
6 udhëzimeve.

7 E pranojmë si çështje ligjore, se në këtë çështje Gjykata
8 do të konsiderojë, do marrë parasysh parandalimin për publikun
9 e gjerë. Megjithatë, ne parashtrojmë se rasti i tij, çështja e
10 tij është e përfshirë në marrëveshjen për pranimin e fajësisë.
11 Nuk ka absolutisht asnjë nevojë për efekt parandalues ndaj z.
12 Bahtijari. Ka dy parime ligjore të ndryshme - parandalimi i
13 përgjithshëm dhe parandalimi konkret për atë, pra, ndaj tij.
14 Dhe parashtrim jonë është që nuk ka nevojë të parandalohet një
15 burrë i vjetër që vuan i sëmurë nga shumë gjendje, nga shumë
16 gjëra të cilat i përmenda në seancë private.

17 Komentet tona janë si në vijim. Këto janë dy vepra
18 penale, akuza për një ngjarje, për një ngjarje të vetme apo
19 për një seri ngjarjesh.

20 Ndala pak sa të ndërrohen ekipet e sigurisë.
21 Faleminderit.

22 Këto janë dy akuza për një ngjarje apo një sërë ngjarjes,
23 për atë bëhet fjalë vetëm për një vizitë dhe disa telefonata.
24 Kemi një marrëveshje për pranimin e fajësisë të qartë që kjo
25 ishte një ofertë për përfitim dhe jo kërcënim. Marrëveshja për

1 pranimin e fajësisë për të është bërë përpara se ndonjë
2 dëshmitar të vinte në Gjykatë dhe përpara se të fillonte
3 gjykimi.

4 Më datën 5 prill 2023, z. Bahtijari vepronte, po
5 vepronte, ka vepruar sipas udhëzimeve. Z. Devaney dje tha në
6 faqen 75 të transkriptit të djeshëm, po citoj, "Kontakti i
7 parë nuk funksionoi". Qëndrimi jonë është që kjo bën rolin e
8 z. Bahtijari edhe më të vogël.

9 Dëshmitari 1, siç e dini, është në gjendje të përshkruajë
10 sjelljen e z. Bahtijari. E shtjelluam këtë në seancë private.

11 Siç shtjelluam edhe në seancë private atë që themi për
12 çështje që qartësisht e zvogëlojnë fajësinë e z. Bahtijari.
13 Kjo ishte vetëm një vizitë. Përveç kontakteve telefonike
14 minimale pas datës 5 prill 2023, z. Bahtijari nuk kishte
15 luajtur, nuk luajti asnjë rol tjetër. Ai nuk u përfshi në
16 ngjarje të datës 12 prill 2023 dhe ishte, thjesht, nuk ishte
17 vetvetja duke ofruar një përfitim apo një dhuratë. Nuk krijoi
18 karakteristika rënduese për veprën penale. Nuk ka dënime
19 penale, nuk ka dënime të mëparshme. Ai bashkëpunoi kur u
20 arrestua, u përgjigj dhe nuk u përpoq fare të kishte alibi.

21 Tani sa i takon masave zbutëse, masave lehtësuese që
22 sipas nesh janë të rëndësishme.

23 Ftojme Trupin Gjykses të marrë parasysh të gjitha
24 parashtrimet që kemi bërë ne në lidhje me dënimin dhe të
25 gjitha shtojcat konfidenciale që kemi përmendur ne në seancë

1 private. Ajo që po ju them unë tani është thjesht një
2 përmbledhje për hir të parimit të oralitetit në mënyrë që të
3 dëgjohen masat lehtësuese.

4 Në letër nuk duket shumë i moshuar. Mbase në këtë sallë
5 ka persona që janë mbase në të njëjtën moshë, po ai është në
6 fakt më i moshuar. Ju keni hollësi për problemet që ka ai me
7 shëndetin të cilat shërbejnë për të ulur dënimin në vetvete.

8 Po mbi të gjitha, është një baba, një baba i mirë, një
9 baba i dashtun dhe që e duan. Është një gjysh, një gjysh i
10 dashtun dhe e duan shumë. Është një anëtarë i komunitetit me
11 karakter shumë të mirë që e duan dhe e respektojnë anëtarët e
12 komunitetit.

13 Kur e vizitua, na ftuan dhe në një ceremoni mortore në
14 mënyrë që të bënim ne ngushëllimet në emër të tij, në mënyrë
15 që ai të shkonte dhe t'i jepte ngushëllimet përmes Hagës, meqë
16 nuk ishte në shtëpi. Ai është qendra e familjes së tij.

17 Ndonjëherë është e vështirë të kuptohet në familje shumë të
18 ngushta pasoja që mund të ketë kjo kur i heqin një person të
19 afërt. Ju mund ta kuptoni këtë nga provat që ju kemi dhënë ne
20 për hir të dënimit të z. Bahtijari.

21 Ai është njeri që punon fort. Ka punuar gjithë jetën për
22 ta mbështetur familjen.

23 Ai është një person që i ka mbijetuar luftës dhe këtë e
24 di të gjithë publiku, të gjithë personat në vendin e tij i
25 kanë shpëtuar, i kanë mbijetuar sulmeve dhe gjenocidit. Ju

1 keni informacione se çfarë i ka ndodhur fshatit të tij. E di
2 gjithë publike që është ende një tank i prishur në një kodër
3 në fshatin e tij për t'u kujtuar të gjithëve atë që ka ndodhur
4 se ka dhe fjalë të shkruara në një ndërtesë sepse tanku dhe të
5 tjerët hynë në atë fshat dhe në të njëjtën kohë banorët e
6 fshatit shkuan në mal dhe jetuan në mal për t'i shpëtuar
7 vdekjes. Është një fshat i bukur rural. Këta persona kanë
8 mbijetuar së bashku dhe ai ka luajtur një rol të rëndësishëm
9 në këtë fshat.

10 Ky fshat është i njohur edhe ju dini edhe moshën e
11 fëmijëve të tij. Si mund ta mbaje një fëmijë gjallë në ato
12 kushte në male, prandaj duhen respektuar prindërit e këtyre
13 fëmijëve, përfshirë këtu z. Bahtijari.

14 Ai ka përkrahjen e komunitetit të tij. Ai ka ndihmuar për
15 ta rindërtuar me duart e veta atë fshat. Dhe ju keni
16 përshkrime se çfarë i ka ndodhur atij fshati dhe çfarë i ka
17 ndodhur kafshëve dhe çfarë i ndodhi dhe kopshtit të tij dhe
18 guximin që tregoi ai në shtëpinë e tij dhe në oborrin e tij
19 edhe përshkrimet se ku ka jetuar ai derisa u rindërtua
20 shtëpia.

21 Ai ka lidhje shumë të forta me familjen dhe me
22 komunitetin.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Bahtijari, mirë jeni? Keni nevojë për ndonjë gjë?

25 I AKUZUARI BAHTIJARI: S'kam.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Pothuajse mbarova.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Njëherë përgjigjuni keni nevojë për diçka, z. Bahtijari? Okej.

5 Doli. Në rregull.

6 ZNJ. GERRY [Përkthim] Sikurse e dini familja e tij është
7 ndikuar në mënyrë të jashtëzakonshme edhe i përmenda këto në
8 seancë private. Ju e dini se çfarë pasojash ka pasur ky proces
9 gjyqësor mbi atë dhe mbi familjen e tij dhe keni dhe
10 përshkrimin nga anëtarët e komunitetit të tij dhe ju duhet të
11 dilni në përfundimin që ky persona duhet të shkojë në shtëpi.
12 Kanë nevojë për atë në shtëpi.

13 Ka pasur më shumë vështirësi se të tjerët në paraburgim.
14 Situata e tij është shumë e trishtë. Duhet të jetë në shtëpi
15 me familjen e tij për kohën që i ka mbetur. Ne mendojmë se kjo
16 duhet të bëhet menjëherë. Dhe ju lutem që ta merrni parasysh
17 nga data 10 dhjetor, nga ajo ditë.

18 Ju lutem, të gjeni një dënim që merr parasysh lirimin e
19 tij të menjëhershëm këtë ditë, 19 dhjetor, pra, 2024, që sot.
20 E kuptojmë që kjo ju vendos ju nën trysni të jashtëzakonshme.
21 Nëse nuk mund ta pranoni këtë kërkesë sot, ju lutem ta lironi
22 sa më shpejtë që të jetë e mundshme.

23 Këto ishin parashtrimet e mia.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Do t'i jap fjalën Prokurorit tani.

2 Ju e dëgjuat kërkesën për lirimin e menjëhershëm, ju
3 lutem bëni dhe ju parashtimin tuaj në lidhje me këtë.

4 Z. DEVANEY: [Përkthim] Parashtimi i Prokurorisë është që
5 ne kemi rënë dakord për dy vjet mes palëve për këtë çështje
6 gjyqësore. Dhe ky është dënimi më i ulët që është dhënë për të
7 akuzuarit në këtë lëndë gjyqësore. Është një dënim i drejtë, i
8 përshtatshëm edhe mbulon edhe faktorët lehtësues që përmendi
9 avokatja.

10 Ky dënim ka marrë parasysh faktin që i akuzuari ka
11 pranuar fajin, kohën e kur e ka pranuar fajin, bashkëpunimin
12 nga i akuzuari që në fakt ka qenë i kufizuar, ka pas një
13 pranim të kufizuar, karakteri i të akuzuarit edhe roli i z.
14 Bahtijari në këtë vepër penale krahasuar me të akuzuarit e
15 tjerë, sigurisht edhe parashtimet lidhur me gjendjen
16 shëndetësore të të akuzuarit.

17 Sa i takon qasjes së 5 prillit, është e rëndësishme të
18 kuptojmë saktësisht për çfarë bëhet fjalë.

19 Nga faktet për të cilat kemi rënë dakord, thuhet si në
20 vijim:

21 "Gjatë 5 prillit 2023, i pandehuri Ismet Bahtijari i tha
22 Dëshmitarit 1 se duhet të tërhiqte dëshminë e tij përpara
23 Dhomave të Specializuara të Kosovës."

24 Nëse shohim tek fakti në Aktakuzë që është paragrafi 9:

25 "Bahtijari shkoi në shtëpinë e Dëshmitarit 1 dhe i tha

1 Dëshmitarit 1 që e kishte kontaktuar Shala kohët e fundit dhe
2 e kishte dërguar t'i thoshte Dëshmitarit 1 që të tërhiqte
3 dëshminë e tij."

4 Pra, në thelb është kontaktuar Dëshmitari 1 në shtëpinë e
5 tij dhe i kanë thënë se ish-komandanti i UÇK-së Haxhi Shala
6 thotë që duhet të tërheqësh dëshminë."

7 Pra, thjesht tërhiqte dëshminë. Në këtë moment s'është
8 dhënë asnjë përfitim.

9 Kjo deklaratë duhet të merret parasysht në kontekstin e
10 një mjedisi të ndërhyrjes së vazhdueshme ndaj dëshmitarëve në
11 Kosovë.

12 ZPS-ja e parashtron që i vetmi përfundim logjik për këtë
13 deklaratë është frika dhe shqetësimet, frika dhe shqetësimi
14 për veten dhe për familjarët, që është pikërisht ajo që ka
15 ndodhur në këtë rast.

16 Dhe ky është e lidhur dhe me frikën që lidhet me z.
17 Bahtijari dhe kjo frikë është dëmi në këtë rast.

18 Pra, ky rezultat, jo vetëm për z. Bahtijari edhe për z.
19 Shala e z. Januzi të cilët e vunë në lëvizje këtë veprim.

20 I nderuar Gjykatës, kalojmë ju lutem një çast në seancë
21 private që të trajtojmë disa parashtrime të tjera që përmendi
22 dhe Avokatja.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Kalojmë në seancë private, ju lutem.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Vazhdoni.

19 Z. DEVANEY: [Përkthim] Patjetër.

20 Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë janë një

21 -- kanë natyrë të rëndë për sigurinë e integritetin e

22 proceseve gjyqësore. Vepra të tilla penale minojnë zbulimin e

23 të vërtetës dhe pengojnë procesin në përgjithësi.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

25 lutem keni një shënim nga përkthyesit të ngadalësoheni. Ju

1 lutem ngadalësohuni.

2 Z. DEVANEY: [Përkthim] Atëherë, ndikimi i këtyre veprave
3 penale si pjesë e klimës të vazhdueshme të frikësimit nuk mund
4 të lihet mënjanë. Dëshmitarët e Mbrojtur të DHSK-së mund të
5 kontaktojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të jenë objekt i
6 veprimtarive penale dhe kjo ka një efekt të jashtëzakonshëm në
7 besimin e publikut dhe efekshmërinë e urdhrave dhe vendimeve
8 të kësaj Gjykate. Prandaj, ndëshkimi përmes një dënimi
9 sinjifikant të konsiderueshëm e mbron këtë besim të publikut.

10 Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja i përgjigjet shkurtimisht një
11 pike që ngriti i akuzuari. Avokatja e z. Bahtijari përmend
12 deklaratat e dëshmitarëve që ka nxjerrë për të thënë që më 5
13 prill, pra, 5 prill 2023, z. Bahtijari ka qenë i frikësuar,
14 prandaj ZPS-ja ju lutet që të merrni parasysh të njëjtat
15 deklarata dhe frikën që të akuzuarit në mënyrë kolektive i
16 kanë shkaktuar viktimave që kanë shënjestruar.

17 Në një analizë përfundimtare dënimi me dy vjet në këtë
18 lëndë gjyqësore është një dënim për të cilin kemi rënë dakord
19 dhe është i drejtë dhe duhet pranuar nga Trupi Gjykses.
20 Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit, z. Prokuror.

23 Ka ndonjë gjë konkrete që doni të thoni për kërkesën për
24 lirim të menjëhershëm sot?

25 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

1 Z. DEVANEY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, si pjesë e
2 marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ZPS-ja thotë që duhet të
3 merret parasysh dhe koha që ka qenë në paraburgim, të zbritet
4 pra, kështu që ne i qëndrojmë afatit apo burgimit me dy vjet.
5 Avokatja pastaj ka të drejtë të ndjekë mjete të tjera
6 juridike, po kjo nuk kërkon nevojë -- nuk ka -- dhe kjo nuk
7 kërkon, domethënë, kohë të konsiderueshme shtesë për praninë e
8 atë akuzuarit këtu.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Avokate do ta trajtoj menjëherë. Do vendos menjëherë për këtë.
11 E thamë më herët gjatë ditës, do ta përsëris dhe një herë,
12 Trupi Gjykes sot nuk do të marrë vendim lidhur me
13 marrëveshjen e fajësisë dhe as me dënimin, ç'ka do të thotë që
14 do vazhdojmë me rendin e ditës që kishim parashikuar për sot.
15 Sot nuk do të ketë lirim.

16 ZNJ. GERRY: [Përkthim] E kuptova këtë. Atëherë unë ju
17 lutem ta lironi sa më shpejt që të jetë e mundur. A mund të
18 kundërpërgjigjem shkurtimisht lidhur me disa aspekte që
19 përmendi Prokurori?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
21 mund ta bëni këtë dhe e kemi parasysh parashtrimet tuaja dhe
22 do të vijojmë siç kishim parashikuar në rendin e ditës për
23 sot. Dhe pas jush edhe Prokurori mund të japë mendimin e vet.
24 Ju lutem vazhdoni.

25 Mund të reagoni sigurisht ndaj parashtrimeve të

1 Prokurorit.

2 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Nuk isha e sigurt a e kuptova siç
3 duhet. E falënderojmë Prokurorinë që e merr parasysh
4 bashkëpunimin e z. Bahtijarin, karakterin e tij, rolin e tij
5 krahasuar me të tjerët, siç u shpreh dhe vetë nga z. Devaney.

6 Por, na shqetëson mënyra sesi Prokurori e përkufizoi
7 vizitën e 5 prillit, ku tha që mbase ka thënë gabimisht, mbase
8 s'e ka thënë me dashje, po ai sugjeroi që kjo ka qenë një
9 vizitë që ka qenë pa iu ofruar një premtim. Unë besoj se nuk
10 ka dashur të thotë diçka që nuk është e përmendur tek faktet
11 për të cilat kemi rënë tashmë dakord, sepse e gjithë
12 veprimtaria është kryer në bazën e një premtimi dhe jo të një
13 kërcënimi. Pra, dua që ta sqarojmë, që ta dimë të gjithë që z.
14 Bahtijari nuk po e kërcënonte Dëshmitarin 1, po ishte në
15 shkëmbim të një premtimi, iu premtua një përfitim.

16 Në rast se Prokurori thotë që nuk ka dashur të thotë
17 këtë, do bëjmë një parashtrim ndryshe.

18 E falënderojmë Prokurorinë që e kupton edhe gjenden e z.
19 Bahtijarin, frikën dhe shqetësimet e tij. E vlerësojmë po
20 ashtu që Prokuroria e pranon faktin që z. Bahtijari është një
21 karakter i pëlqyeshëm.

22 Ne parashtrojmë sa i takon informacione që keni në lidhje
23 me aspektet që janë ngritur për gjendjen shëndetësore, unë do
24 të kërkoj prapë të kalojmë në seancë private. Unë besoj se
25 përmbushen kushtet legjislative në mënyrë që ju të dilni në

1 përfundim që z. Bahtijari, në fakt, ka qenë në rrethana
2 rënduese.

3 Gjithashtu, unë mendoj që ne nuk jemi shumë larg
4 Prokurorisë, por mbase për z. Devaney disa muaj nuk janë
5 shumë, por për të akuzuarin, sidomos në këtë sezon pushimesh
6 është shumë e rëndë, sepse familjet do të festojnë edhe për
7 ne, mendojmë që për z. Bahtijari kjo një periudhë shumë e
8 gjatë.

9 A mund të kalojmë dhe një herë në seancë private, ju
10 lutem, që të trajtojmë një a dy aspekte të tjera.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. Kalojmë në seancë private.

13 Dhe mund të na e shpjegoni pastaj pse duhet të kalojmë në
14 seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Avokate, fjala është për ju.

4 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Dy aspekte të fundit. Sa i takon
5 "gjuhës së frikësimit", këtë e kemi trajtuar qysh në fillim të
6 parashtrimeve tona kur folëm për dënimin e përgjithshëm. Ne e
7 pranojmë këtë, ku në këtë rast do të ketë një dënim të
8 përgjithshëm. Dhe kjo është e përfshirë dhe në marrëveshjen
9 për pranimin e fajësisë sa i takon z. Bahtijari. Dhe ne e
10 përsërisim parashtrimin tonë që nuk ka nevojë për dënim
11 specifik. Kështu që "gjuha e frikësimit" nuk ka pse të jetë e
12 zbatueshme apo të zbatohet prej jush për z. Bahtijari.

13 Në përgjithësi, ne duam të themi që faktorët lehtësues
14 janë shumë, shumë, shumë të rëndësishëm në këtë situatë më
15 shumë se çdo situatë tjetër se ekziston nevoja për të kuptuar
16 personat, persona në vende ku ju i gjykoni. T'i kuptojmë ata,
17 familjet e tyre, shëndetin e tyre, komunitetin e tyre dhe të
18 kuptojmë se si dënimet duhet të zbuten për një person në moshë
19 të thyer dhe të sëmurë që ka vepruar nën udhëzimin e të
20 tjerëve.

21 Për të gjitha arsyet që i kemi parashtruar tashmë në
22 seancë publike dhe private, kjo është një çështje emocionale,
23 është emocionale. Ai nuk duhet të qëndrojë më gjatë këtu.
24 Sipas nesh ju duhet të vendosni që ai nuk duhet të qëndrojë
25 këtu shumë gjatë. Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Prokurori ka parashtrime të mëtutjeshme për t'ju

4 kundërpërgjigjur avokates?

5 Z. DEVANEY: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë më shumë për të

6 thënë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

8 rregull.

9 Vazhdojmë atëherë me pjesën e fundit të kësaj seance sa i
10 takon marrëveshjes së fajësisë për z. Bahtijari.

11 Avokate, në paragrafin 63, që mban numrin 620, ju keni
12 thënë, dhe po citoj, se:

13 "Pranimi i fajësisë sugjeron se z. Bahtijari e kupton
14 gabimin e veprimit, mënyrën, faktin që ka vepruar gabim dhe
15 nuk ka të ngjarë ta përsërisë, dhe kjo heq nevojën për
16 ndëshkim specifik përmes dënimit."

17 Marr parasysh që ju thatë që z. Bahtijari nuk do të bëjë
18 asnjë deklaratë lidhur me dënimin e tij.

19 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

21 rregull. Sidoqoftë unë do ta pyes vetë z. Bahtijarin. Edhe

22 është i lirë t'i përgjigjet ose jo, ose ju mund të

23 konsultoheni me klientin mbase për t'ja shpjeguar këtë gjë.

24 Nëse doni lirisht mund ta bëni.

25 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Nuk është nevoja. Ai e bëri shumë

1 të qartë që nuk do të flasi në këtë sallë gjyqi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
3 këtë?

4 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Për asgjë, sidomos për këtë.
5 Sidoqoftë mund t'ja bëni pyetjen. Nëse ai nuk e kupton
6 pyetjen. Nëse ai nuk po e kupton pyetjen atëherë do të flas
7 vetë me z. Bahtijari, por besoj që ju mund ta bëni pyetjen.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Bahtijari, kam një pyetje po nuk e ke për detyrim që t'i
10 përgjigjesh. Do t'ju pyes z. Bahtijari, a je bërë, a je pendu,
11 domethënë, a të vjen keq, a je bë pishman që ke bërë atë që ke
12 bërë dhe për të cilën tashmë është thënë te dokumenti
13 përkatës? A mendoni se ajo që keni bërë ka qenë e gabuar, nuk
14 ka qenë një gjë e mirë?

15 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Domethënë, "Po, je pendu"?

18 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Në shqip] Po,
20 po? [Përkthim] Po për çfarë, ju lutem?

21 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Domethënë besoj që po ju thotë që
22 "po, ka qenë e gabuar".

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ja
24 bëj unë pyetjen në këtë formë atëhere.

25 Z. Bahtijari, e pajtoheni me mua që ajo që keni bërë ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë mbi Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 63

1 qenë e gabume? Këtë po thoni? Se nuk po përpigem tua diktoj
2 fjalët, por kur thoni "po" ju po thoni që po thoni "po, ajo që
3 kam bërë atëherë ka qenë e gabuar"?

4 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, q'ashtu.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
6 na thuash pse mendon që ka qenë e gabuar? Pse mendon që ka
7 qenë gabim ajo që bëre? Bahtijari, e dëgjove, e kuptove
8 pyetjen?

9 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, e kuptova. Po s... s'muj me ju
10 përgjigj.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
12 atëherë, mirë. E lemë me kaq. E lemë me kaq z. Bahtijari.

13 Nëse nuk ka gjë tjetër për marrëveshjen për pranimin e
14 fajësisë nga palët, po shoh një herë nga ZPS-ja.

15 Z. DEVANEY: [Përkthim] Nuk kemi asnjë parashtim tjetër.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni
17 diçka ju lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë?

18 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull.

21 Këtu mbyllet seanca, z. Bahtijari për marrëveshjen e
22 fajësisë midis jush dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

23 Siç e thashë më herët do të kemi një seancë përmbledhëse.
24 Trupi Gjykes në fakt ka vetëm një aspekt, vetëm një çështje
25 që do të sqarohet apo të zgjidhet. Mund ta bëjmë tani ose mund

1 të bëjmë gjysëm ore pushim.

2 Me përjashtim të rasteve kur palët kanë aspekte të tjera
3 për të trajtuar sepse në atë rast duhet të bëjmë patjetër një
4 pushim. Nuk dua ta zgjas shumë pushimin sepse ka dy orë që
5 vazhdon pa pushim. Jemi ne, po janë dhe përkthyesit që kanë
6 nevojë për pushim.

7 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Unë shpresoj ta trajtojmë të
8 gjithën tani, mos ta mbajmë më shumë z. Bahtijari këtu. Mbase
9 nuk është mirë për atë që të bëjmë pushim dhe të kthehemi. Do
10 ju lutesha që të vazhdonim. Nga ana ime s'do ketë asnjë
11 parashtim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
13 folët për vete. Faleminderit.

14 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Në rregull. E marr parasysht.

15 Shoh Mbrojtjen e z. Januzi.

16 Z. REES: [Përkthim] Jemi në duart tuaja.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Vazhdojmë tani, ju lutem. Ju lutem
18 vazhdojmë tani në mënyrë që të përfundojmë seancën.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, atëherë.

21 Prokurori i Specializuar çfarë mendon?

22 Z. DEVANEY: [Përkthim] Edhe ne parapëlqejmë që të

23 vazhdojmë tani në mënyrë që të përfundojmë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

25 rregull. Atëherë po vazhdojmë.

1 Z. Bahtijari, të lutem ki dhe pak durim me ne. Do të
2 vazhdojmë me pjesën e fundit të kësaj seance dhe kjo pjesë e
3 fundit ka të bëjë me krejt ekipet Mbrojtëse, me krejt ekipet e
4 Mbrojtjes të të akuzmve.

5 Është një çështje e pazgjidhun lidhur me kërkesën për
6 riklasifikim që e ka bë Mbrojtja e z. Januzi. Është fjala për
7 parashtrimin 612, Shtojca 1. Gjatë seancës së djeshme,
8 Mbrojtja e Januzit, dhe kërkesës së tij iu bashkuan dhe ekipet
9 e tjera të Mbrojtjes, kërkoi që të riklasifikohet si
10 konfidenciale Shtojca 1 e parashtrimit 612. Dhe kishte edhe
11 kërkesa të tjera të ngjashme, në lidhje ndoshta jo me
12 riklasifikimin po me dhënien e një farë përmbledhje të atij
13 dokumenti. Dhe gjithashtu dëgjum parashtrimet e Prokurorit në
14 lidhje me shtojcën për të bë të paktën redaktimin saj përpara
15 se të ndrohej klasifikimi.

16 Trupi Gjykues ka marrë parasysh parashtrimet e të gjitha
17 palëve, të ZPS-së, të Mbrojtjes së z. Shala, të Januzit dhe të
18 Bahtijarit, dhe ju referojmë te faqja 526 e transkriptit të
19 djeshëm.

20 Në këtë drejtim theksojmë se përgjigja e ZPS-së ndaj
21 kërkesës së Trupit Gjykues në shtojcën e parashtrimit 612 mund
22 të gjenden në paragrafin 15 dhe 16 të parashtrimit të ZPS-së
23 618 që është i klasifikuar si konfidencial. Prandaj, të gjitha
24 palët kanë qasje në atë dokument. Për pasojë Trupi Gjykues
25 konstaton se nuk është më e nevojshme që të mbahet klasifikimi

1 aktual i Shtojcës 1 të parashtrimit 612 meqë përmbajtja e
2 këtij dokumenti është -- i është bërë e ditur ekipeve të
3 Mbrojtjes.

4 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të bëjë riklasifikimin e
5 shtojcës, do të heqë shënimet *ex parte*, me përjashtim nëse
6 ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë atë riklasifikim. Në qoftë se
7 do të ketë kundërshtim, atëherë do të vazhdojmë me
8 parashtrimet e palëve do të fillojmë me Prokurorinë. Pra, në
9 qoftë se do të ketë kundërshtim.

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] A mund të më jipni një
11 minutë vetëm sa për t'u konsultu me kolegët?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] po,
13 sigurisht.

14 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, të
16 konfirmoj se ZPS-ja nuk kundërshtoj zgjidhjen që propozoi ju.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Atëherë, ne do ta udhëzojmë Zyrën Administrative që të
20 jetë shënimin *ex parte*, parashtrimi 612, Shtojcës 1.

21 Dhe me kaq përfundon urdhri jonë gojor.

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Kemi një parashtrim tjetër
23 që duam të bëjmë përpara se të përfundojmë seancën sot. Mund
24 ta bëjmë tani apo më vonë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 mund ta bëni tani atë parashtrim në mënyrë që ta
2 rrumbullakësojmë seancën. A mund ky parashtrim të bëhet
3 publikisht?

4 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Urdhnoni.

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja ka reflektuar për atë
8 që u tha dhe ndodhi në seancën e djeshme dhe të sotme, dhe
9 veçanërisht në lidhje me paragrafin 12 të marrëveshjeve për
10 pranimin e fajësisë, për ndryshimet e mëtejshme që i ka
11 rekomanduar Trupi Gjykses.

12 Është qëndrim që ndajmë së bashku me Mbrojtjen se nuk ka
13 nevojë për kurrfarë ndryshimi tek marrëveshjet meqë duke
14 përfshirë edhe paragrafin 12, ato janë hartuar në mënyrë të
15 kujdesshme në mënyrë që t'i përfshijnë të gjitha mundësitë e
16 eventualitetet duke përfshirë edhe ato që i kemi shqyrtuar në
17 seancat e djeshme dhe të sotme.

18 Përveç kësaj, se kjo do të shkaktonte një farë komplikimi
19 të panevojshëm potencial që mund të krijohej pas seancave të
20 djeshme dhe sotme. Çdo i akuzuar ka konfirmuar kuadrin e
21 marrëveshjes dhe çfarë kuptojnë ata për pasojat e asaj
22 marrëveshje.

23 Prandaj, statusi i një marrëveshje për pranim të fajësisë
24 të mëtejshme pasi që të akuzuarit tashmë janë vetëdeklaruar
25 fajtorë dhe si Trupi Gjykses do të bindej se këto marrëveshje

1 përmbushin e kriteret e rregullës 94 pa e përsëritur gjithë
2 procedurën, pra kjo do të ishte vështirësia që do të mund të
3 lindje.

4 Prandaj, ne mendojmë se në qoftë se bëjmë diçka më shumë
5 me këtë moment, mund të shkaktojë komplikime të panevojshme të
6 mundshme në procedurat e mëtejshme.

7 Kaq kisha për të thënë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 A ka diçka për shtu dikush na ekipet e Mbrojtjes?

11 Z. REES: [Përkthim] Vetëm desha të konfirmoj se është
12 qëndrimi i përbashkët i Mbrojtjes dhe i ZPS-së.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Avokati i z. Shala.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Pasi e kam diskutuar këtë me ZPS-së
17 në mëngjes, ne pajtohemi.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtja e z. Bahtijari?

20 ZNJ. GERRY: [Përkthim] S'kemi asnjë gjë për të thënë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi
22 Gjykses do të jep udhëzime të mëtejshme pas pushimit dimnor të
23 Gjykatës dhe sa më shpejt që është e mundur.

24 Nuk e di në qoftë se keni diçka për të shtuar.

25 Z. REES: [Përkthim] Po, kam dy çështje për të ngritur si

1 pjesë e kësaj seance përmbyllëse.

2 E para, duke mbajtur parasysh kalendarin që ka caktuar apo
3 afatet që ka caktuar Gjykata për kontaktet me Zyrën e
4 Përfaqësimit të Dëshmitarëve dhe Viktimave, unë kërkoj nga
5 Trupi Gjykoës që të nxjerrë një vendim për të miratuar
6 marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe të caktojë dënimet në
7 përputhje me ato marrëveshje duke mbajtur parasysh dhe kohën e
8 kaluar në paraburgim. Unë do të kisha kërkuar që ky vendim të
9 dalë përpara pushimit.

10 Kjo çështje e zbatueshmërisë të zhdëmtimeve, për mendimin
11 tim, është një çështje tërësisht e ndarë dhe prandaj mendoj që
12 vendimi në lidhje me vendimet e fajësisë, marrëveshjet e
13 fajësisë duhet të merret pavarësisht prej çështjes së
14 zhdëmtimeve.

15 Në çështjen Mustafa, Salih Mustafa, dhe mendoj në
16 çështjen e Pjetër Shalës, Çështjen 05 dhe 04 respektivisht,
17 Trupi Gjykoës kishte juridiksionin për të trajtuar çështjen e
18 zhdëmtimeve edhe në një datë të mëvonshme. Dhe unë e lus
19 Trupin Gjykoës që të merr këtë qëndrim edhe në këtë çështje,
20 veçanërisht duke marrë parasysh kuadrin e marrëveshjeve për
21 pranimin e fajësisë dhe dënimet që janë rekomanduar aty dhe
22 duke marrë parasysh dhe kohën e konsiderueshme që tashmë kanë
23 kaluar të akuzuarit në paraburgim.

24 Për sa i përket urdhrit të dytë gojor që dhatë, e nderuar
25 Gjykatëse, dhe në lidhje me afatet për kontaktimin e Zyrës për

1 Pjesëmarrjen e Viktimave, ne ju referuam versionit të
2 aktakuzës së 6 dhjetorit 2024.

3 Urdhri gojor që nxori Trupi Gjykues ishte përpara datës 6
4 dhjetor dhe versionit të 6 dhjetorit të marrëveshjeve dhe nuk
5 është përdorur ai version i aktakuzës gjatë këtyre seancave të
6 marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Prandaj, unë sugjeroj që
7 ky dokument të mos i jepet Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave
8 në këto rrethana, sepse do të krijonte vetëm ngatërresa dhe
9 paqartësi për atë zyrë.

10 Prandaj, me respekt do t'i kërkoja Trupit Gjykues që ta
11 ndryshojë urdhrin gojor që dhatë dje pjesërisht.

12 Kjo ishte pjesë e urdhrin të dytë që dhatë dje se Zyra e
13 Pjesëmarrjes së Viktimave -- kësaj zyre duhet t'i dorëzohet
14 aktakuza e 10 korrikut së bashku me marrëveshjet e pranimin të
15 fajësisë, dhe për mendimin e tim këto janë dy instrumentet që
16 janë të mjaftueshme për atë zyrë.

17 Këto ishin edhe parashtrimet e mia.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Nuk e di në qoftë se ka për të shtu diçka Mbrojtja e z.
21 Shala?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm desha të them se i mbështes
23 të dy kërkesat që bëri z. Rees. E kam parasysh se ky vit pune
24 i Gjykatës përfundon nesër. Dhe 17 janari është dita e
25 ardhshme e caktuar si ditë pune në Gjykatë pas pushimit dimnor

1 të Gjykatës. Ne vetëm kërkojmë, në qoftë se ka mundësi, që kjo
2 çështje të trajtohet me një urdhër me shkrim që ai urdhër t'ju
3 komunikohet të tre akuzuarve dhe kjo të bëhet sa më shpejt që
4 të jetë e mundur në mënyrë që të mos i shtyjmë punët deri në
5 fund të janarit se kjo do të ishte e padrejtë për të tre të
6 akuzuarit, dhe nuk do të ishte në përputhje me përpjekjet që
7 janë bë për të arritur këto marrëveshjes për pranimin e
8 fajësisë me ZPS-në.

9 Prandaj, do t'ju lus, të nderuar Gjykatës, që të nxirrni
10 një vendim me shkrim sa më shpejt që është e mundur dhe pastaj
11 të caktoni një seancë në ditën e parë të mundshme të punës pas
12 pushimit të Gjykatës, dikun pas 17 janarit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit për parashtrimin.

15 A keni ju për të shtu diçka znj. Gerry?

16 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Unë e kam bë qëndrimin tim të
17 qartë, por i përkrah kërkesa që i kanë paraqitur palët.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 Theksoj se Prokuroria i ka bërë të gjitha parashtrimet që
21 ka dashtë t'i bëjë në këtë drejtim. Nuk e di në qoftë se ka
22 diçka për t'u përgjigjur, si përgjigjen ndaj parashtrimeve të
23 Mbrojtjes së z. Januzi.

24 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Shkurtimisht. Thjesht të
25 them se i dëgjum parashtrimet e Mbrojtjes dhe ju bashkohemi

1 kërkesës së kolegëve tonë dhe pajtohemi me ato kërkesa.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
3 propozoj që tani të bëjmë një pushim prej gjysëm ore dhe
4 pastaj mund të vazhdojmë me këto diskutime. Mendoj që duhet të
5 bëjmë një pushim se ka njerëz që kanë punu prej orës 1.00 pa
6 ndërprerje deri tani.

7 Z. Bahtijari mund ta lejojmë që të largohet nga salla për
8 pjesën e dytë të seancës dhe ne përsëri takohemi këtu në katër
9 pa 15 minuta.

10 ZNJ. GERRY: [Përkthim] A jeni duke thënë se mund të
11 kthehet në qendrën e paraburgimit se s'ka nevojë të kthehet
12 këtu?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
14 pikërisht atë.

15 ZNJ. GERRY: [Përkthim] A mund të më lironi edhe mua që të
16 shkoj? Do të jetë bashkëmbrojtësja këtu.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
18 është vendimi juaj. Ajo sidoqoftë që mund të mbetet këtu sepse
19 përfaqëson klientin tuaj.

20 Z. REES: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, a mund ta lejoni
21 edhe z. Januzi që të mos merr pjesë në pjesën e dytë të
22 seancës sepse ai pajtohet që ne t'i trajtojmë çështjet
23 administrative pa praninë e tij?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull. Mund të vazhdojmë edhe ashtu.

1 Seanca mbyllet dhe vazhdojmë në orën 3.45.

2 --- Pauza fillon në orën 15.18

3 --- Seanca rifillon në orën 16.13

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
5 se vini.

6 Që të shënohet në procesverbal do të konstatoj praninë e
7 palëve dhe nëse ka ndryshime.

8 Z. Prokuror, keni fjalën.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Tazneen Shahabuddin,
10 Prokurore nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.
11 Zëvendësprokurori i Specializuar Ferdinand Ward --
12 Ferdinandusse, Ndhmësprokurori John Devaney dhe Menaxherja e
13 lëndës Line Pedersen.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 I kthehem Mbrojtjes. Z. Bahtijari, mund të na thoni kush
17 është i pranishëm.

18 ZNJ. CARRIN: [Përkthim] Faleminderit. Përmes videolidhjes
19 kemi të pranishëm administratorin Caitie Delaney. Në sallën e
20 gjyqit znj. Yuqing Liu, zyrtare -- ndihmëszyrtare ligjore. Dhe
21 unë jam bashkëmbrojtësja Marion Carrin.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
23 dëgjova fjalinë e fundit. Nuk i dëgjova fjalët e fundit.

24 ZNJ. CARRIN: [Përkthim] Unë jam bashkë-mbrojtësja Marion
25 Carrin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
2 ndonjë arsye që po shohim ekranin pa parë personin? Sepse nuk
3 mund të vazhdojmë kështu.

4 Mbrojtja e z. Januzi.

5 Z. REES: [Përkthim] Mbrojtja e z. Januzi ka të njëjtën
6 përbërje si më herët, me ndryshimin që z. Januzi nuk është në
7 sallë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit. E njëjta gjë vlen për z. Bahtijari, nuk është i
10 pranishëm. Të dyve ju është dhënë leje të largohen.

11 Pastaj Mbrojtja e z. Shala.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk ka ndryshime në përbërjen e
13 ekipit të Mbrojtjes së z. Shala.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
15 dy pika për të trajtuar, që do t'i trajtoj tani.

16 Së pari, lidhur me urdhrin gojor mbi zhdëmtimet i lëshuar
17 nga Trupi Gjykses dje, me 18 dhjetor 2024, Trupi Gjykses
18 qartëson se Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave duhet të marrë
19 Aktakuzën e Konfirmuar të datës 10 korrik 2024 që është
20 parashtrimi i protokolluar me numrin 379, Shtojca 1, dhe jo
21 Aktakuzën e Konfirmuar të datës 6 dhjetor 2024 që mban numrin
22 parashtrimit të protokolluar 619, Shtojca 1.

23 Trupi Gjykses qartëson gjithashtu se marrëveshjet për
24 pranimin e fajësisë duhet edhe ato t'i përcillen, t'i jepen
25 Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave.

1 Gjithashtu, Trupi Gjykues dëshiron të qartësojë se Trupi
2 Gjykues do të jetë në gjendje të vendosë për marrëveshjet mbi
3 pranimin e fajësisë, përfshirë edhe dënimin vetëm pas marrjes
4 së raportimit nga Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave. Data për
5 këtë është caktuar 24 janar 2025 si dhe komentet e palëve dhe
6 data për këtë është 27 janar 2025. Çështja e zhdëmtimeve, nëse
7 paraqitet do të trajtohet si pjesë e marrëveshjes për pranimin
8 e fajësisë, në bazë të rregullës 94(2)(c) e Rregullores.

9 Do të jap udhëzime shtesë në kohë lidhur me këtë.

10 Këto ishin qartësimet nga ana e Trupit Gjykues.

11 Falënderoj palët edhe një herë për pjesëmarrjen e tyre,
12 kolegët, të gjitha shërbimet dhe ekipet të Zyrës
13 Administrative.

14 Seanca mbyllet.

15 --- Seanca mbyllet në orën 16.18

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25